Ajrimi i klasës

Kohëzgjatja	**4-5 orë**
Periudha e vitit	**Në çdo periudhë të vitit**
Vendi	**Në klasë**
Materialet	**Bllok shënimesh, lapsa, pajisje për monitorimin e dioksidit të karbonit**
Objektivat	• **Të nxjerrë në pah rëndësinë e ajrimit dhe efikasitetin e energjisë të sistemeve të ajrimit**
Metodat	**Lojra, diskutim, dhënie mendimesh**

DISKUTIM

Dritaret dhe ajrimi

- Përpara veprimtarive, është e dobishme të bëhet një diskutim me fëmijët rreth cilësisë së ajrit në klasë. Pyetini fëmijët nëse ata e konsiderojnë cilësinë e ajrit të mirë apo të keqe. A kanë fëmijët dhimbje koke rregullisht? Sa herë hapen dritaret gjatë ditës? Kur hapen ato?

- Diskutoni se çfarë kuptoni me ajrim të mirë dhe ajrim të keq. Kërkojuni fëmijëve të vëzhgojnë dritaret e klasës. Ata mund të bëjnë një eksperiment të thjeshtë për të parë sa mirë mbyllen dritaret. Kërkojuni të hapin dritaren, vendosni një copë letër mbi kornizën e dritares, më pas mbylleni dritaren sërish. Nëse ju e tërhiqni copën e letrës kur dritarja është e mbyllur, atëherë mund të themi se dritaret nuk mbyllen mirë. Pyetini fëmijët nëse mund të thonë përse ndodh kjo gjë. A janë kanatet e kalbura apo të pambërthyera mirë? Kërkoni të kontrollojnë disa dritare të tjera në ndërtesën e shkollës dhe të mbajnë shënime rreth vëzhgimeve të tyre. Pasi fëmijët të kenë mësuar më shumë rreth ajrimit, ata mund të përgatisin një poster dhe ta varin në mjediset e shkollës për të ndarë informacionin edhe me nxënës të tjerë. Gjithashtu, një grup nxënësish mund të dalin vullnetarë për të kontrolluar të gjitha dritaret e shkollës dhe të përgatisin një raport për drejtuesit e shkollës. Nëse dritaret mbyllen mirë, raporti duhet të paraqesë nëse ka ajrim të mirë për të krijuar kushtet e përshtatshme të punës. Fëmijët duhet ta përsërisin ushtrimin në shtëpi dhe të shkruajnë një raport për prindërit e tyre (kështillohet që prindërit të pyeten paraprakisht).

- Pyetjet e mëposhtëme mund të jenë udhëzuese për diskutimin në klasë:
  - Cilat dritare të shkollës janë të dëmtuara?
  - A vëreni ndryshime në dritaret që shohin nga jugu, krahasuar me ato që shohin nga veriu?

PUNË NË GRUPE

Kontrolli i dritareve

- Tregojuni fëmijëve fotot e mëposhtme, të cilat ilustrojnë skema të ndryshme të ajrimit natyror si dhe sasinë e kohës së nevojshme për qarkullimin e plotë të ajrit brenda dhomës.



Shpjegoni që Figura A paraqet ajrimin me dritare dhe derë të hapur plotësisht; Figura B paraqet ajrimin vetëm me anë të dritarevë të hapura; Figura C paraqet ajrimin me dritare të hapura pak, në drejtimin anësor; Figura D paraqet ajrimin me dritaren e hapur pak, në drejtimin vertikal dhe derën e hapur plotësisht; dhe figura E paraqet ajrimin me dritaren e hapur pak, në drejtimin vertikal.

- Pyetini fëmijët se cila metodë përdoret në klasën e tyre (A, B, C, D apo E). A lihen dritaret dhe dyer hapur për një kohë të mjaftueshme?

- I ndani fëmijët në grupe dhe kontrolloni të gjitha dritaret në çdo klasë të shkollës. U sugjeroni të shkruajnë një raport për drejtuesit e shkollës rreth kohës së nevojshme për të ajrosur çdo klasë të saj.